



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:175080

Datë: 09.09.2021

Numri i dokumentit: 02159968

P.nr.578/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit A. M. nga G. për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-ës të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokatja Fjolla Ukshini nga Gjilani duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr...../2021 të datës 17.08.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik me datë 03.09.2021 mori dhe shpalli ndërsa me datë 09.09.2021 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri A. M. nga babai R. dhe nëna F. e lindur A., i lindur me datë ..... në Gjilan ku edhe jeton në rrugën “.....”, numër..., ka të kryer... vite të shkollës fillore, i martuar, baba i .. fëmijëve, i pa punësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 03.08.2021 në intervalin kohor 12:40-12:50 minuta në rrugën “.....”, në Gjilan, saktësisht afër selisë së LDK-ës i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo tjetrin me dashe ka kryer vjedhje në dëm të dëmtuarës A. J. ashtu që i njëjti përmes xhamit të automjetit i cili kishte qenë i hapur e kishte fut dorën në automjetin “.....”, me ngjyrë të zezë dhe tabela të regjistrimit ..... në pronësi të dëmtuarës së lartcekur dhe më pas e hap derën, futet brenda dhe nga aty kishte vjedhur një portofol me ngjyrë të zezë ku kishte rreth 20 € të letrës, 700.00 denar të Maqedonisë së Veriut, një kartelë të Bankës Ekonomike, një kartelë së sigurimit “.....”, një kartelë të “H.P.....”, një sim kartel të “I.”, një telefon celular Iphone 12 Pro Max GG në vlerë prej 1300 € dhe si pasojë të dëmtuarës i shkakton dëm material në vlerë të papërcaktuar.

-Me çka ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,42,43,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 dhe 365 të KPP-ës, të pandehurin e lartcekur:

### E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje 7 (shtatë) muajve dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro) të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

Në bazë të nenit 79 të KPRK-ës të pandehurit të lartcekur koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 05.08.2021 deri me datë 03.09.2021 do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

E dëmtuara A. J. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### ARSYETIM

#### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 18.08.2021 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr...../2021 kundër të pandehurit A.M. nga Gjiilani për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Më datë 03.09.2021 në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit, i pandehuri A. M. dhe mbrojtësja e tij e caktuar sipas detyrës zyrtare avokatja Fjolla Ukshini nga Gjiilani. Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri i lartcekur ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e saj, me ç' rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit dhe rrjedhimisht shqyrtimit fillestar ka vazhduar me deklaratimet e palëve lidhur me dënimin.

## 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2021-CA-..... i datës 05.08.2021, raporti i oficerit, deklaratat e të pandehurit A. M., deklarata të dëmtuarës A. J., vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve, vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara, CD-ja me video incizim, foto dokumentacioni si dhe shkresat e tjera të lëndës po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i pandehuri A.M. nga Gjilani ka kryer veprën vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij me ç'rast me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ku mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit në të cilën përfshihet fakti se i njëjti ka qenë plotësisht i përgjegjshëm për veprimet e tija dhe se në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka lënguar nga ndonjë sëmundje mendore apo ndonjë sëmundje tjetër, faktin se i njëjti ka paraqit një shkallë të lartë të vetëdijes dhe dëshirës për ta kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor si dhe faktin se i njëjti këtë vepër e ka kryer me dashje dhe atë direkt po ashtu gjykata pati parasysh pranimin e fajit nga ana e të pandehurit.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata mori pranimin e fajësisë nga ana e tij meqenëse i njëjti fajësinë për kryerjen e kësaj vepre e ka bërë në çdo fazë të procedurës penale, pendimin e tij të cilin gjykata e mori si pendim të thellë dhe real, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit sepse i njëjti në çdo fazë të procedurës penale ka shprehur keqardhje për veprimet e tij dhe njëherit edhe i ka kërkuar falje të dëmtuarës për këto veprime, premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të pandehurit sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del i pandehuri këtë veprë penale e ka kryer me dashje dhe atë direkt sepse i njëjti e ka ditur se me veprimet e tij do të shkaktohet pasoja e ndaluar dhe përkundër kësaj i njëjti e ka dëshiruar përkatësisht ka ndërmarrë veprimet për shkaktimin e saj ashtu siç përshkruhet në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithashtu si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori edhe këmbëngulësinë e shfaqur nga ana e të pandehurit për kryerjen e veprës penale sepse siç shihet nga përshkrimi faktik po ashtu edhe nga provat e çështjes del se i njëjti përmes xhamit të hapur në automjetin e markës .... në pronësi të dëmtuarës kishte hap derën e automjetit dhe nga aty kishte vjedhur sendet siç përshkruhet në dispozitiv të këtij aktgjykimi andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin nën kufijtë e paraparë ligjor ashtu siç parashihet në nenin 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 5.Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e saj të dëmtuarën A. J. nga Gj. e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

#### 6.Vendimi lidhur me llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar.

Gjykata bazuar në nenin 79 të KPRK-ës të pandehurit të lartcekur kohën e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 05.08.2021 e deri në datën 03.09.2021 ia llogarit në dënimin e shqiptuar me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.578/2021 me datë 09.09.2021

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.